

Bendis KRAJA

**VËSHTRËSITË DHE PIKËPAMJET POLITIKO-
SHOQËRORE TË SHTYPIT LAIK TË SHKODRËS GJATË
VITEVE TË LUFTËS SË PARË BOTËRORE**

Abstrakt:

Ngjarjet politike që po kalonte Shqipëria në përgjithësi, dhe Shkodra në veçanti, me specifikat e tyre, thyerjet e shpeshta politike që u shoqëruan me ndërrime të njëpasnjëshme të pushtuesve, shpresat e mëdha, zhgënjimet tragjike, ngjarjet e komplikuara, me veprime diplomatike të fshehta, me rivalitete të egra për pushtime, copëtimet drastike të trojeve shqiptare, synimet për të mos njohur më pas atë shtet që vetë e njohën, në kufijtë që vetë i vendosën padrejtësisht, përjetimi dhe reagimi mbarëpopullor, të gjitha këto gjetën pasqyrim gjerësisht dhe denjësisht në shtypin laik të kohës. Kështu, në rrethanat aq të ndërlikuara dhe me pasoja tragjike për Shqipërinë e për të gjithë Ballkanin, shtypi i Shkodrës bëri shumë për të shprehur aspiratat e popullit, por edhe për të sensibilizuar opinionin publik botëror e për të ushtruar presion aq sa mundej mbi fuqitë europiane për zgjidhjen e drejtë të çështjes shqiptare. Në raport me qytetet e tjera të Shqipërisë, Shkodra kishte numrin më të madh të gazetave laike, që shihnin dritën e botimit gjatë viteve të Luftës së Parë Botërore. Konkretisht ishin nëntë të tilla, si “Besa shqiptare”, “Taraboshi”, “Shqypnia e re”, “Atdheu”, “Populli”, “Drita e Popullit”, “Lidhja Kombëtare”, “Shkodra” dhe “Posta e Shqypnisë”. Vetëkuptohet se ato ishin një balancë mjaft e vlefshme, në një ambient ku prej vitesh vepronte shtypi fetar i të dy krahëve. Aq më tepër rëndësia e tyre rritet, për faktin se,

përgjithësisht, botuesit e tyre qenë njerëz patriotë, që duke afruar pranë gazetave të veta penda të tilla, si Gj. Fishta, R. Siliqi, H. Mosi, K. Suma, M. Gramano, N. Nikaj, M. Kakarriqi etj., i bënë një shërbim të madh çështjes kombëtare. Në situatat e ndërlikuara të krizës ballkanike e të shtetit të brishtë shqiptar, kur Shkodra kalonte çaste specifike krahasuar me pjesën tjetër të atdheut, “shtypi pasqyroi prirjet themelore e mbizotëruese të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, duke luajtur kështu rolin e një “partie” nacionaliste”. Në faqet e këtij shtypi u shprehën jo vetëm ndjenjat, bindjet, analizat e kërkesat e elitës politike, por edhe të të gjitha masave, pak ose aspak të shkolluara. Gazetat me shkrimet e veta u munduan të ishin të pavarura dhe të trajtonin probleme nga më të ndryshmet.¹ Mirëpo jo gjithmonë gazetat e këtyre viteve ia arritën këtij qëllimi. Në këtë kohë, kur njëri pushtues zëvendësonte tjetrin, secili duke ia ditur rëndësinë e madhe që ai kishte në influencën e tij në popull, u mundua me forma të ndryshme ta shfrytëzonte e ta kalonte në anën e vet.

Fjalët kyç: *Lufta e Parë Botërore, Shqipëria, Shkodra, shtypi.*

Kur forcat ndërkombëtare u tërhoqën nga qyteti i Shkodrës, qyteti u administrua nga Këshilli i Konsujve dhe një Komision Qeveritar, në përbërje të të cilit ishin gjashtë përfaqësues myslimanë e gjashtë të besimit katolik.² Fillimi i Luftës së Parë Botërore e gjeti Shqipërinë në përgjithësi e Shkodrën në veçanti, në një gjendje të vështirë e të turbullt.

¹ Botuesi i “Besa Shqiptare” në datën e parë të daljes së kësaj gazete shprehet: “Nji fletore qi mos t’mundet me folë lirshëm nuk mundet kurr me çfaqë t’dreten e âsht e ndrydhun ndër mësimet e ndër fjalë t’nevojshme për mirsim”.

² Ata përfaqësonin personalitete të spikatura të qytetit, në fushën politike e shoqërore, mbiemra të shquar nga paria e Shkodrës, si Preng Pasha, Sylço Bushati, Shuk Serreqi, Muharrem Kazazi, Shan Deda, Isuf Golemi, Filip Kraja, Myrto Llazani, Ndoc Çoba, Haxhi Hafizi, Alush Lohja. *Ballafaqime politike në Shqipëri (1897-1942)*, Sejfi Vllamasi, Tiranë 1995, 93.

Edhe pse gëzonte statusin e veçantë të administrimit ndërkombëtar, kjo nuk e ndihmoi Shkodrën karshi aspiratave të vjetra të mbretit Nikolla, i cili e shihte këtë qytet si “*ëndrra e tij e shenjtë e gjithë jetës*”. Kështu, kur tri vendet fqinje (Greqia, Italia e Serbia) i kishin shkelur vendimet e Londrës për Shqipërinë, edhe shteti i vogël malazez vendosi të merrte pjesën që “i takonte”³ dhe nisi drejt Shkodrës forcat më të zgjedhura ushtarake, duke e pushtuar atë më 27 qershor 1915. Duke i nuhatur dhe analizuar ngjarjet e situatat, ashtu siç edhe u kishte paraprirë nëpërmjet shkrimeve të ndryshme, gazeta “Populli,” me intuitën e analistit, një ditë para se trupat malaziasë të pushtonin Shkodrën, ngre pyetjen: *Për mbi çështjen e Shqipnis a ka ndonji marrëveshje ndërmjet Romës, Belgradit e Cetinës?*⁴

Kjo ishte pikërisht situata në Shkodër, tepër e ngarkuar me konfuzion politik, “shpërnda çetash e hutue”, “pa mik e dashamir”⁵, sepse asnjëra nga Fuqitë e Mëdha nuk iu përgjigj apeleve të përsëritura të shkodranëve për mbrojtje, që ndihmoi Cetinën të pushtonte qytetin. Natyrisht që administrimi i qytetit nga Këshilli i Konsujve, në të cilin përfaqësoheshin shtetet e dy grupimeve tashmë në luftë njëri me tjetrin, ndikoi që popullsia e mbetur pa ndonjë drejtim dhe e pakthjellët për çka po ndodhte, të mos organizonte dot qëndresë të armatosur ndaj agresorëve. Gazeta “Populli” që dilte në Shkodër, tri ditë pas hyrjes së malazezëve shprehej: *“Një popull i pakrye, i parregullt e organizim, i patop e mitraloz, i pambrojtje e mbështetje, i ngatërruem me propaganda gjithfarësh, s’mund t’i qëndronte një ushtrie të rregullt.”*⁶ Tashmë Këshilli i Konsujve që përfaqësonte regjimin ndërkombëtar pushoi së ekzistuari. Në qytet u vendos regjimi civil i pushtimit, drejtuar nga një guvernator malazez. Por Shkodra që ata gjetën, në këtë kohë ishte qyteti ku jetonin e

³ *Historia e popullit Shqiptar III, Periudha e Pavarësisë*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Toena, Tiranë 2007, 81.

⁴ Gaz. “Populli”, Shkodër, nr. 89, viti II, datë 26 qershor 1915, art. “*Italia, Serbia e Mali i Zi*”.

⁵ Gaz. “Lidhja Kombëtare”, Shkodër, nr. 3, datë 14 qershor 1915.

⁶ “Populli”, Shkodër, nr. 93, 30 qershor 1915.

punonin figura të njohura politike e atdhetare nga e gjithë Shqipëria, ishte kthyer në një qendër të lëvizjes mbarëkombëtare, në një kryeqytet politik të vendit.⁷ Për ta zhbërë këtë situatë, në qytet filloi një valë arrestimesh, internimesh, ndjekjesh e vrasjesh të aktivistëve të lëvizjes atdhetare shqiptare. Ndër të internuarit ishin Luigj Gurakuqi, Sotir Peci, Aqif pashë Elbasani, Eshref Frashëri etj. U vranë Mehmet Shpendi, Çerçiz Topulli e Mustafa Qulli, si dhe Isa Boletini me djemtë e tij e disa përkrahës.

Krahasuar me qytetet e tjera të Shqipërisë, Shkodra kishte numrin më të madh të gazetave laike që shihnin dritën e botimit deri në mbarim të Luftës së Parë Botërore. Ishin nëntë të tilla: “Besa Shqypare”, “Taraboshi”, “Shqypnia e re”, “Atdheu”, “Populli”, “Drita e Popullit”, “Lidhja Kombëtare”, “Shkodra” dhe “Posta e Shqypnisë”. Vetëkuptohet se ato ishin një balancë mjaft e vlefshme, në një ambient ku prej vitesh vepronte shtypi fetar i të dy krahëve. Aq më tepër që rëndësia e tyre rritej, për faktin se, përgjithësisht, botuesit e tyre qenë njerëz patriotë, që duke afruar pranë gazetave të tyre penda të tilla, si Gj. Fishta, R. Siliqi, H. Mosi, K. Suma, M. Grameno, N. Nikaj, M. Kakarriqi etj., i bënë një shërbim të madh çështjes kombëtare.⁸

Në kuadrin e masave të rrepta që pushtuesi mori për shtypjen e lëvizjes kombëtare e të qëndresës së armatosur në vend, duhet parë edhe trajtimi fshikullues ndaj shtypit, ndalimi i shtypjes së gazetave “Populli” dhe “Lidhja Kombëtare”, të cilat ishin kthyer në tribuna të mendimit më të përparuar patriotik, idetë e së cilave për pavarësinë kombëtare e moscopëtimin e Shqipërisë shkonin në kah të kundërt me

⁷ Nikolla Ivanaj jep këtë renditje për figurat politike në Shkodër: “Preng Bibdod-pasha, prijës i Mirditës, Aqif pashë Biçakçiu i Elbasanit, Lef Nosi, Mehmet pashë Dërralla i Tetovës, Kara Sait pasha Kosova, Sotir Peci, Idhomene Kosturi, Isa Boletini, Bajram Curri, Rrok e Luigj Berisha, Çerçiz Topulli me vllazni, Mustafa Qulli, Rexhep Mitrovica, Bedri Pojani, Qerim Begolli, Sejfi Vllamasi, Koço Kota, Fejzi Alizoti, Vesel Efendija - kadiu i Gjirokastrës, Kristo Floqi, Sali Nivica, Mustafa Pipa, Ilija Koto, Duro Guri etj.”

⁸ Bendis Kraja, tezë doktrature “Lëvizja arsimore-kulturore në Shkodër në vitet 1912-1920”, 63.

synimet e pushtuesit. Edhe lejimi i gazetës së Ndoc Nikës, “Besa Shqypare”, u bë me një sërë kushtëzimesh. Së pari iu ndërrua titulli, u quajt “Zani i Shkodrës”, në këtë mënyrë ajo zhvishej nga elemente tipike kombëtare të titullit fillestar si “besa” dhe shkante në analogji me gazetën që dilte në Mal të Zi, “Glas Crnegore” (Zëri i Malit të Zi).⁹ Së dyti, gjatë gjithë pushtimit malazez, që prej numrit të parë më 29 korrik 1915, ajo u imponua të jepte njoftime të pushtuesit, pa mundur të bënte ndonjë shërbim kombëtar.

Gjatë pushtimit austro-hungarez, konsulli Halla vërente se gazeta “përdor karshi nesh një gjuhë me një ton pak miqësor”, ndaj ai e qortoi me anë të kryeabatit të Mirditës, “pas të cilit gazeta e ndryshoi qëndrimin e saj”.¹⁰ Kryekomanda e ushtrisë austro-hungareze edhe pse e përkrahu zhvillimin e shtypit në vend, u siguria që gazetatat të mbeteshin brenda kontrollit politik të saj, vuri kusht që botimi të bëhej në gjuhën shqipe dhe gjermane, si dhe të botoheshin në të të gjitha njoftimet dhe komunikatat zyrtare. Lulatjet e botimit nga katër në tri apo në dy herë në javë, por edhe lulatja e formatit të gazetës që ndryshonte vazhdimisht, kanë të bëjnë me vështirësitë e shumta, përmes së cilave ecte në ato kohëra puna për botimin e gazetës, vështirësi si të karakterit teknik, financiar e material, por edhe censurues e ndëshkues nga sunduesit.

Ndër gazetatat më të rëndësishme të kohës ishte “Taraboshi”, që drejtohej nga italo-shqiptari Terenc Toçi (1913-1914). Pikëpamjet e tij politike apo edhe sulmet kundër organeve të administratës internacionale të Shkodrës, por shpesh edhe kundër politikës italiane në Shqipëri, sollën edhe ndëshkimet e armiqësitë e këtyre fuqive. Ai u thirr për t’u paraqitur në konsullatën italiane më 26 nëntor 1914, ku dhe u arrestua “për motive të rendit publik”. Më pas u nxor jashtë vendit, u çua në Shëngjin, prej ku u internua në Kozenca të Italisë.¹¹

⁹ Xhevat Repishti, *Lufta për mbrojtjen e Shkodrës në vitet 1918-1920*, Shkodër, Camaj-Pipa, 1998, 27.

¹⁰ Arkivi i Muzeut Historik, Shkodër, F. : DKAHSH, Dok,Vj. 25. 1. 150, datë 18 mars 1915, 17-18

¹¹ AMH, Shkodër, F. Dok. VJ. 25. 2. 271, Nr. 36/P, 67-68, datë 2 shkurt 1915.

Ndër relacionet e konsullit austro-hungarez Halla njoftohemi edhe mbi një propozim, që konsulli francez i bënte Këshillit të Konsujve mbi qëndrimin e nënshtetasit italian Terenc Toçi: “...i cili me anën e botimeve dhe intrigave të tij, është duke prishur qetësinë dhe rendin publik”¹², ndaj dhe kërkonte të merreshin masat e nevojshme. Kjo kërkesë është kundërshtuar nga konsulli austro-hungarez, të cilit akuzat iu dukën “të padokumentueshme e të formuluar në mënyrë të përgjithshme”. Konsulli Halla e vlerësonte në relacionin e tij qëndrimin e “Taraboshit” si të moderuar. Ajo çka e ngrohte më tepër diplomatit austro-hungarez, është fakti që: “Në çdo rast ai ka folur në gazetën e tij në favor të fitores së fuqive qendrore aleate, në të cilën vetëm ai shikonte mundësinë e një të ardhmeje për Shqipërinë.”¹³ Me sa na njofton relacioni, edhe pse i dëbuar, ai e vazhdoi sulmin edhe më ashpër ndaj politikës së Italisë në Shqipëri¹⁴. E vërteta është se Toçi gëzonte shumë simpati në rrethet me ndjenja kombëtare, simpati të cilën ia dha “qëndrimi i tij i pafrikshëm, patriotizmi i tij i zjarrtë, dhe gjuha e tij e hapur me të cilën ai mbronte pikëpamjet e tij” - vëren konsulli Halla.

Pas rregullimit të shumë detajeve e kalimit të shumë pengesave, më 5 dhjetor 1916 doli në Shkodër numri i parë i gazetës “Posta e Shqypnie” (1916-1918). Ajo do të ishte një gazetë gjysmëzyrtare, që subvencionohej nga austro-hungarezët, ndaj dhe është i kuptueshëm ndikimi që ata patën mbi atë çka botohej aty. Nga ana tjetër, fakti se në krye të gazetës qëndronte një atdhetar, si At Gjergj Fishta, bëri që pozitat e saj në përgjithësi të ishin të shëndosha. Mbajtja e kësaj gazete nga Austro-Hungaria vuri në dilemë ekzistencën e një tjetër gazete, që subvencionohej po nga Perandoria

¹² Po aty.

¹³ AMH, Shkodër, F.: DKAHSH, v. 1915, VJ. 25. 2. 271, Nr36/P, Shkodër, datë 2 shkurt 1915, 67-68.

¹⁴ Në një trakt të titulluar “La politica italiana in Albania, note per gli deputati al parlamento”, prej të cilit disa ekzemplarë erdhën edhe në Shkodër, Toçi proteston njëherazi kundër trajtimit që iu bë prej autoriteteve italiane, dhe sulmon rishtazi me ashpërsi politikën e Italisë në Shqipëri.

Dualiste, gazetës “Vllaznia”, që botohej në Vjenë. Mbas debatesh të shumta, sipas përfaqësuesit të Ministrisë së Punëve të Jashtme A. Kral, i cili ishte një përkrahës i zhvillimit të kulturës shqiptare, “nuk ishte e nevojshme lënia pas dore e njëres në favor të tjetrës, pasi shumë mirë mund të ekzistonin të dyja duke krijuar një pasuri të çmueshme të publicistikës shqiptare”

Gazetat me shkrimet e veta u munduan të ishin të pavarura dhe të trajtonin probleme nga më të ndryshmet. Ja si shprehej botuesi i “Besa Shqiptare” në datën e parë të daljes së kësaj gazete: *“Nji fletore qi mos t’mundet me folë lirshëm nuk mundet kurr me çfaqë t’dreten e asht e ndrydhun ndër mësimë e ndër fialë t’nevojshme për mirsimë”*. Mirëpo jo gjithmonë gazetat e këtyre viteve ia arritën këtij qëllimi. Në këtë kohë kur njëri pushtues zëvendësonte tjetrin, secili duke ia ditur rëndësinë e madhe që ai kishte në influencën e tij në popull, u mundua me forma të ndryshme ta shfrytëzonte e ta kalonte në anën e vet.

Raportimet e konsullit Halla u bëjnë me dije eprorëve të tij, se botuesit e gazetës “Populli” i kanë kërkuar atij një ndihmë, një shumë mujore prej afërsisht 300 koronash.¹⁵ Konsulli Halla ishte dyshues, nëse gazeta mund të vazhdonte të dilte pa këtë ndihmë, meqë *“...të dy editorët nuk disponojnë asnjë mjet”*. Por ai nuk nguron t’i propozojë ministrin të Jashtëm Burian në Vjenë: *“Në qoftë se do të bëhet akordimi i ndonjë ndihme, konsullata e përgjithshme do të merrte përsipër për të kontrolluar drejtimin politik të gazetës.”*¹⁶ Një deklaratë e tillë na vërteton se gazetat e tjera, që subvencionoheshin apo merrnin ndihma nga ato, vareshin nga Vjena. Në mënyrë të përsëritur pushtuesit që ndërronin njëri-tjetrin u munduan t’i vënë nënurvejimin e tyre gazetat që dilnin. Analistët e shtypit parashtruan shpesh argumentet tekniko-shkencore dhe argumentuan krijimin e një Shqipërie të pavarur në kufijtë e saj natyrorë. Shpeshherë në faqet e gazetave u botuan artikuj, ku krahas falënderimeve për Austro-Hungarinë dhe Italinë, që mbështetën krijimin e shtetit shqiptar me

¹⁵ AMH, Shkodër, F: DKAHSH, Dok. VJ 25. 1. 150, datë 18 mars 1915, 17-18.

¹⁶ Po aty.

kufij sa më natyrorë, bëhen edhe analiza e kritika ndaj tyre.¹⁷ Analizat synonin të sqaronin opinionin publik edhe për shkaqet e kësaj “dashamirësie” e “proteksioni”. Ato ishin të qarta mbi faktorët gjeostrategjikë dhe gjeopolitikë që ndikuan në politikën e diplomacisë europiane ndaj Shqipërisë, për t’iu kundërvënë shtrirjes së pansllavizmit dhe të Rusisë në Ballkan dhe për të dominuar “në valët e kaltra të detit Adriatik”, “trashëgimi që na lanë stërgjyshit tanë”.¹⁸

Shtypi ngriti gjithashtu zërin kundër urrejtjes etnike e fetare, shpifjeve e intrigave, tendencave pa baza për ta paraqitur popullin tonë të paaftë për vetëqeverisje të egër, pa ndërgjegje kombëtare. “Besa Shqiptare” shkruante: *“Fletoret e Europës janë të mbushura me fjalë të thata e të ithta, e mbarojnë me një fjalë të vetme: Shqiptarët nuk mund të rrijnë n’vedi e se asht nevoja me i nda.”*¹⁹ Kritika të forta nëpërmjet analizave bëri edhe gazeta “Taraboshi”, e cila e dënonte politikën e Europës ndaj Shqipërisë, “ku gjithnji ka pasë t’shame”, “ngatërresat në Shqipëri janë një rrjedhë e ngatërresave të armiqve tanë”²⁰, vërente me të drejtë gazeta. Në të njëjtat pozita qëndronte në pikëpamjet e saj edhe gazeta “Shqypnia e re”. Interes të veçantë paraqet kryeartikulli “Në kjosht nâna mbëlou”, ku kritikoheshin Fuqitë e Mëdha me fjalët: *“Pra, Europë! Që po thue se je nâna e jonë e na fëmija jot, vepro, se me detyrë e ke, mohoji heshtat e gjakpirsave armiq prej trupit foshnjes tande, e mos na mbyll gojen!”*²¹ Analiza e politikës së “dy potencave Adriatike” në lidhje me Shkodrën është e imët. Ashtu si motoja e gazetës që ishte “Të mproj të drejtat kombëtare”, kryeartikulli tërhiqte vëmendjen: *“Italijsot sot po përpiqet që t’i marrin në projtje të vet, të gjith shqiptarët mysliman, ashtu si*

¹⁷ Të njëjtin qëndrim gjejmë edhe te gazeta “Atdheu”, datë 8 shkurt 1913, art. “Austria dhe Shqipëria”.

¹⁸ Gaz. “Atdheu”, datë 28 prill 1913, aut. A. Gurra, art. “C’gjë na shpëtoi”.

¹⁹ Gaz. “Besa shqiptare”, Shkodër, nr. 10, datë 3 qershor 1913, art. “Flasin keq për ne”.

²⁰ Gaz. “Taraboshi”, Shkodër, nr. 24, datë 22 korrik 1913, 2.

²¹ Gaz. “Shqypnia e re”, Shkodër, nr. 43, moti I, datë 7 dhjetor 1913, aut. R. Siliqi, art. “Në kjosht edhe nana mbëlou!”

Austrija shqiptarët katolik. Punë shumë e damshme dhe e rrezikshme për vetqeverimin e Shqypis e bashkimit kombëtar. Kjo gja, po të bahet do të ngatërrojnë, poshtojnë, e ndalojnë Shqypënin në të gjithë punët e saj, aq sa nuk kishte me mujtë me përparue aspak e sidomos në udhë të bashkimit kombëtar pa të cilin s'ka vetqeverim të vërtet".²² Tone të ashpra e shoqërojnë shkrimin deri në fund: "Ky dëshirë e qëllim i protektorëve t'onë (larg kjoshin prej nesh), nuk do të pranohet kurrë prej popullit shqipëtar".²³

Është e kuptueshme se artikuj të tillë e të shpeshtë bënë që gazeta të ndëshkohej disa herë nga autoritetet ndërkombëtare të Shkodrës. Gjoha e dënime mori edhe "Taraboshi" për artikujt e tij të guximshëm si "Mbrojtja komtare", ku haptazi shfaqej mosbesimi te dashamirësia e Austrisë dhe Italisë. Gjithsesi, gazeta nuk reshti në rrugën e saj. Ajo nuk e mbylli gojën kur ishte puna për të kërkuar që Shkodra të përfshihej brenda shtetit shqiptar. "Shkodra a bân a jo pjesë me shtetin e Shqypnis? A e ka t'drejtën e organizimit qytetnuer? Cilat janë arsyenat që ligjtariisht e mâjnë t'dame prej Atdheut?,- vinte ajo në dukje,-Por na s'mund t'kuptojmë në ç'mënyrë pse Shkodra t'ken ligj t'posaçëm e mos t'bahjë pjesë me trung ligitar t'Komsis".²⁴

Shtypi pasqyrooi me realitet gjendjen e rëndë ekonomike, pasojë e politikës grabitqare financiare që ndoqi Mali i Zi në Shkodër. "Nuk gjendet asgja në dugajë"²⁵, "Shumë familje bijnë e çohen pa bukë",²⁶ "Mungesa e bukës ma e randë se në kohë të rrethimit" (krahasimi bëhet me rrethimin e vitit 1912-1913). Çmimi i sheqerit u dyfishua brenda javës së parë të pushtimit.²⁷ Ndërsa në lidhje me

²² Gaz. "Shqypnia e ee", Shkodër, Mot II, datë 22 shkurt 1914, aut. N. Ivanaj, art. "Komedia Austro-Italiane"

²³ Po aty.

²⁴ Gaz. "Taraboshi", Shkodër, nr. 88, datë 2-3 prill 1914, aut. Terenc Toçi, art. "Mbrojtja komtare"

²⁵ Gaz. "Besa Shqyptare", Shkodër, nr. 79, datë 10 korrik 1915, art. "Buk! Buk!"

²⁶ Po aty.

²⁷ Gaz. "Populli", Shkodër, nr. 90, datë 2 korrik 1915.

papunësinë shkruhej: “Asht gjith ky niri pa punë, po nuk gjen punë”²⁸, “tregu ka vdekë”.²⁹

Hyrja e trupave austro-hungareze në Shkodër më 23 janar 1916 u shoqërua me një qëndrim pritës nga ana e popullit të Shkodrës, që ishte shumë i interesuar të largonte nga qyteti ushtritë malaziasë. Por edhe pasojat e këtij pushtimi u ndien shumë shpejt, pasi politika e grabitjes sistematike ekonomike, financiare e tatimore preku rëndë popullin. Memorandumet e revoltat deri në përleshje e burgosje nuk munguan. Masat shtypëse ushtarake pushtuesi i shoqëroi edhe me një propagandë të fortë në favor të tij, duke ndikuar me anë të disa organeve të shtypit në Shkodër, që u bënë zëdhënëse të pikëpamjeve se Shqipëria nuk ishte ende gati për një vetëqeverisje. Gazeta “Vllaznia”, zëdhënëse e qarqeve sunduese të Vjenës, e trajtonte kështu situatën: “...le t’i lamë në një anë o vllazen politiken e poshtërsinat tjera”.³⁰ Nuk munguan në shtyp edhe artikuj, si: “*Pamvarësia t’prin në barbarizëm*”, ku jepej “këshilla”: “*Pra, shqiptar, ruju fort prej msimit t’mrapsht të pavarsisë, n’daç me përparue me t’vërtet*”.³¹

Një manovër politike e Vjenës, për të qetësuar shpirtin e qëndresës shqiptare, ishte dalja para tubimit të popullit të Shkodrës e Ignat Trollmann-it, komandantit më të lartë të ushtrive austro-hungareze në Shqipëri, që nga ballkoni i prefekturës lexoi në gjermanisht një deklaratë (më pas në shqip e lexoi komisari civil, August Kral), ku premtuhej dhënia e autonomisë në të ardhmen, pa dhënë afat, por siç ai vetë shprehej: “Kur shqiptarët të bëheshin të aftë”. Kjo deklaratë antishqiptare befasoi dhe mbushi me indinjatë popullin e mbledhur në tubim E vetmja ndër gazetatat që e propagandoi atë deklaratë ishte “*Posta e Shqipërisë*”, zëdhënëse e pushtuesit, që

²⁸ Gaz. “Zani i Shkodrës”, Shkodër, viti I, datë. 7 nëntor 1915.

²⁹ Gaz. “Zani i Shkodrës”, Shkodër, viti I, datë 14 tetor 1915.

³⁰ Gaz. “Vllaznia”, Vjenë, datë 16 prill 1916, Sipas Xh. Rrepishti, *Lufta për mbrojtjen e Shkodrës në vitet 1918-1920*, 51.

³¹ Rev. “Përparimi”, Shkodër, nr. 2, 1916, 1, art. “*Pamvarësia t’prin në barbarizëm*”

subvencionohej nga ai.³² Sipas komentit të gazetës, proklamata kishte një rëndësi të madhe politike, “*mbasi dishmon se Austro-Ungherija e njëzjyrtarisht tagrin qi Shqypnia ka për autonominë*”.³³

Pas fitores së revolucionit bolshevik më 7 nëntor 1917, për të parën herë u botua nga qeveria sovjetike teksti i Traktatit të Fshehtë të Londrës. Shtypi i Shkodrës u tregua koherent me shtypin botëror në ribotimin e tij. Shumë nga dyshimet e vëna në pah nga ky shtyp, shumë nga parashikimet e tij tashmë u vërtetuan. Ai ishte një grusht për Italinë dhe vuri në lëvizje gjithë patriotët shqiptarë për të mos lejuar ricopëtimin e vendit.³⁴

Dalja e trupave austro-hungareze nga Shkodra u shoqërua me një veprim tejet të rëndë për jetën e qytetit. Tri urat me rëndësi aq jetike për Shkodrën e zonat përreth “u rrenun me bume” e disa ditë më parë ishin djegur edhe disa baraka që shërbenin si spitale të vogla. Ja si i përshkruan pasojat e këtij veprimi gazeta tjetër “Posta e Shqypnis”: “*Gjithë pazari e me te krejt populli i qytetit e i katundeve për rreth është tue ndie dâmin e të prishunit t’urës së Bahçallekut e të Bunës; pazari është prishë, katundarët nuk mund të hijnë aspak në Pazar e kështu vunë vendi jonë.*”

Vendosja e Shkodrës nën pushtimin ndërraleat solli rrethana të reja edhe për shtypin e qytetit. Ja si shkruan “Besa shqyptare”: “*Masi qi Fletorja para se të shtypet do të çohet në komandë para çensuret, punë qi na ep ngurrim, nuk munden kshu kndej me caktue ditën qi mund të dalin as sa herësh në javë botohet*”.³⁵ Situatat e reja gjetën reagim në faqet e shtypit, i cili u mundua t’i paraprinte asaj që mund të ndodhte, por edhe të nuhaste me inteligjencë nga kush mund të pritej ndihma. “*Vilsoni nuk mundet me lypë një Shqipni të ndrydhët e të shëmtueme, një Shqipni të pakrye e të pakrahë, por të unjishme, të gjallë, të madhe, aq sa përfshin gjithë rrethi i saj e sa përmbledh gjithë*

³² Gaz. “Posta e Shqypnis”, Shkodër, nr. 14, Vjeti I, datë 24 janar 1917, 1, art. “*Proklamata e kryekomandantit Trollman*”.

³³ Po aty.

³⁴ V. Duka, *Qytetet e Shqipërisë në vitet 1912-1924*, Toena, Tiranë 1997, 100.

³⁵ Gaz. “Besa Shqyptare”, Shkodër, nr. 6, Vjeti VII, datë 23 nëntor 1918, 2.

gjinden e gjuhës amtare e me liri të plotë".³⁶ Shpresat e shtypit ishin se: "Kena për të pas një Shqypni jo sikur e ndau mbledhja e Londonit, por një Shqypni mas orakullit t' Amerikës."

Rivaliteti italo-serb për sundimin e Adriatikut Lindor u shfaq me tërë ashpërsinë e tij për Shqipërinë e Veriut e veçanërisht për Shkodrën. Kjo ishte arsyeja, që shtypi nëpërmjet analizave e protestave, kërkonte që Shkodra jo veç të mos shkëputej nga Shqipëria, por të shpallej kryeqytet i saj. "Shkodra nuk mundet me durue pa neveri e lëvizje të madhe të shpirtit një mënyr tjetër qi e dan prej Shqipniet".³⁷ Përmes studimeve mbi "rranjët e rrjedhën e kombit tonë" u argumentua në shtyp pseja e kësaj kërkese: "...n'emër t'Drejhtësis s'Njerzimit e të parimit të komsis... për me rrnuë vetqeverimisht e të bashkuem mbrenda sinoreve të veta të natyrshme, sikurse edhe karakteristika e veçantë e gjuhës e rresës edhe e adeteve e lypë edhe e ndanë prej të gjitha komsinave të tjera që e rrethojnë, e lypë qi Shkodra të jenë e bashkueme ende administrativisht me tjetrat pjest e Shqipnis tue e çpallë për kryeqytet".³⁸

Rrezikut që paraqiste për interesat dhe kauzën shqiptare vënia e Shkodrës nën mekanizmin e pushtetit ndërkombëtar, shkodranët iu përgjigjën duke kërkuar të kremtonin Ditën e Flamurit, festën e Pavarësisë së tyre. Shtypi i kontribuoi duke i paraprirë ardhjes së kësaj dite nëpërmjet artikujsh, të cilët vinin në pah rëndësinë e kësaj dite fatlume. Përpjekjet serbe për të influencuar te komanda franceze, që të mos lejonte festimin e kësaj dite, dështuan. Koloneli Bardi de Fourtou, komandant i ushtrive aleate, botoi këtë shpallje në gazetë: "Shqyptarë! Më keni lypun autorizimin me kremtue një festë që e keni fort për zemër. Ket liri jau kam dhanun me gëzim të madh, pshtetun urtiis suej

³⁶ Gaz. "Besa Shqyptare", Shkodër, nr. 6, Vjeti VII, datë 7 nëntor 1918. Art. "Vilsonoi e Shqypija".

³⁷ Gaz. "Besa Shqyptare", Shkodër, nr. 4, Vjeti VII, datë.15 nëntor 1918. Art. "Na dhe gjuha jonë".

³⁸ Po aty.

për qi mos të ndodhin asnji trazim e qi festa juaj të zhvillohet me ma të madhen qetësi".³⁹

Shtypi i këtyre viteve ishte kështu një tribunë, prej nga u ngrit zëri për problemet me rëndësi jetike për jetën e kombit. Ai nuk qe thjesht një pasqyrues, ai ishte një zëdhënës i reagimit mbarëpopullor, u parapriu ngjarjeve, sensibilizoi opinionin vendas e të huaj, analizoi e gjeti shkaqe e arsye, gjeti aleatë, si parashikues e kritikues të rreptë, ai shprehu në faqet e tij aspiratat dhe kërkesat e mbarë popullit, *"shprehu ndjenjat e fuqishme spontane kombëtare jo vetëm të elitës politike, por edhe të të gjithë masave të pashkolluara"*,⁴⁰ duke ndërthurur në artikujt e tij redaksionalë e analitikë kërkesat në ndërveprim të të gjitha shtresave sociale në Shkodër e në mbarë vendin.

Duke u munduar të kryejë sa më mirë rolin e tij, por edhe të mbijetojë ndaj ndëshkimeve, censurimeve, gjobitjeve deri edhe mbylljeve e internimeve, shtypi ia doli mbanë në misionin e tij. Na duket me vend të citojmë këtu Terenc Toçin, një prej botuesve që u dënua në disa lloj formash nga pothuajse të gjitha llojet e pushtuesve, teksa shprehet: *"Dua të kthej për pesë minuta në mjeshtrin teme të dashtun me mallë të fort e të padukshëm: gazetarin! Dua të kthej n'ket mjeshtri e me rrokë pendën me të cilën e për të cilën kam vuajtur shumë, por kam provue edhe se katër rreshta të shkrueme me nderë e me gjykim, vrasin ma tepër se katër mijë pushkë dhe i fusin tmerrin zemrës së të keqit."*

³⁹ Gaz. "Besa Shqiptare", Shkodër, nr. 7, Vjeti VII, datë 28 nëntor 1918, 4, art. "Komanda e Ushtrive Bashklidhuna të Shkodërs".

⁴⁰ F. Rama, artikull i përmëndur, te *Studime Historike*, nr 3-4, 1999, 45.